

Gjimnazi “Raqi Qirinxhi”

Punë me shkrim (Shkrimi i esesë përshkruese)

Gjuhë Shqipe

Klasa e 10-të

Temat e esesë do të jenë:

1. a) Hapni faqen me adresë www.albanianart.net (Albanian Art-Robert Elsie).
 - ✓ Klikoni “*Painting*”.
 - ✓ Klikoni tek fotoja e piktorit Kolë Idromeno.
 - ✓ Klikoni tek vepra e tretë (Idromeno 03) me titull “*Dasma shkodrane*”.
- b) Përshkruani pikërisht këtë imazh pikturë duke u përqëndruar në :
 - Sfondin e tablosë
 - Kontekstin kohor dhe social
 - Arkitekturën e objekteve
 - Atmosferën dasmore
 - Kostumet kombëtare të paraqitura në tablo
 - Portretet, aspekte të karakterit që theksohen
 - Detaje të ndryshme që vë në dukje autori
 - Larmishmëria e ngjyrave
 - Aspekte teknike të tablosë
 - Ndjesitë që ju përcjell
2. a) Klikoni tek <http://www.youtube.com/watch?v=iiDCxnsHczo>
Dëgjoni me vëmendje këngën “*Në një flamur të pandarë*” dhe shkruani një ese përshkruese nisur nga vargjet “*Gjithmonë do të jetë Shqipëria / sa të ketë dhé e gjak shqiptar*”.
- b) Klikoni tek <http://www.youtube.com/watch?v=EYnRVZKFRaM>
Dëgjoni me vëmendje këngën “*Albanian*” dhe shkruani një ese përshkruese nisur nga vargjet “*Unë shoh kuq e zi / jetoj kuq e zi / marr frymë kuq e zi / besoj kuq e zi*”.
- c) Klikoni <http://www.youtube.com/watch?v=gezM8YVusgg>
Dëgjoni me vëmendje këngën “*Shqipe*” dhe shkruani një ese përshkruese nisur nga vargjet “*O sa mirë me kenë shqiptar / o sa mirë me i thënë botës: “Unë vij nga Shqipëria*”.

 - ✓ Përshkruani ndjesitë që ju përcjell secila prej këtyre këngëve. (Përshkrimi i ndjenjave, gjendjes shpirtërore apo e një situatë emocionale)
 - ✓ Zgjidhni momente të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar që paraqiten në klipet e këngëve të mësipërme dhe bëjini pjesë të esesë.
 - ✓ Përpiquni ta përfshini lexuesin ta përjetojë ngjarjen, nisur nga kënvështrimi juaj.
 - ✓ Përqëndrohuni në krijimin e një përshtypjeje të qartë zotëruese, në të cilën domethënia e asaj që po përshkruani të jetë jetë më e rëndësishme se vetë ngjarja.

Vlerësimi:

A. ZHVILLIMI I IDEVE

- tema është kuptuar qartë në pikëpamje përmbajtjesore
- reflekton kuptimin e temës
- përshkruan duke mbështetur idenë e tij në raport me imazhin a këngën
- përdor detaje mbështetëse, i mbështet idetë e veta me shembuj
- përcakton drejtimet ku do të ndërhyhet për përshkrim.

(40 pikë)

B. STILI DHE ORIGJINALITETI

- ka qartësi mendimi, gjuhë eseistike
- origjinaliteti, ka dhënë përgjigje krijuese
- fjalori i pasur, i përzgjedhur

(20 pikë)

C. STRUKTURA E ESESË DHE ORGANIZIMI

- respektton elementet e strukturës së esesë
- idetë të lidhura në mënyrë logjike, koherencë, unifikim paragrafësh
- interpretim i mirë i fakteve të zgjedhura, idetë janë të plota dhe të përfunduara

(20 pikë)

D. TREGUES GJUHËSORË. PËRDORIMI I GJUHËS

- pasuria gjuhësore
- larmia sintaksore
- drejtshkrimi
- saktësia drejtshkrimore

(20 pikë)

Shënim:

- Nxënësit do të zgjedhin njërin nga temat 1 ose 2 (a ose b ose c).
- Punët do të dorëzohen më **datë 05.12.2016**. Dorëzimi do të bëhet në rrugë manuale ose në rrugë elektronike në adresën: gertidallta@yahoo.com ose në Facebook. Për dorëzimin manual përdorni formatin e paraqitur në faqen 3 dhe 4.
- Shkrimi: Times New Roman; madhësia:12

SUKSESE !

Mësuesi i lëndës Gerti Dallta

Korçë, më 24.11.2016

Gjimnazi "Raqi Qirinxhi"

Punë me shkrim (Shkrimi i esesë përshkruese)

Lënda : Gjuhë Shqipe

Emri Mbiemri _____

Klasa _____

Tema _____

ZHVILLIMI I PUNËS

